



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 6 gusht 2015
Nr. ref.: VHK 814/15

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin nr. KI142/14

Parashtrues

Bajram Bajgora

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
Ac. nr. 1429/2014, të 7 korrikut 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bajram Bajgora nga Podujeva (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin (Ac. nr. 1429/2014, të 7 korrikut 2014) të Gjykatës së Apelit, i cili i është dorëzuar atij më 4 gusht 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me *“nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ)”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën nëpërmjet postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin se e ka pranuar një kërkesë me emrin e tij dhe se e njëjta nuk është e nënshkruar. Me atë rast, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të paraqitet në Sekretariatën e Gjykatës brenda 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese për të nënshkruar kërkesën.
7. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI142/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI142/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 21 janar 2015, Gjykata i dërgoi një shkresë të dytë parashtruesit të kërkesës me të cilën i përkujtoi atij se akoma nuk e ka nënshkruar kërkesën e tij, dhe se nënshkrimi i saj është parakusht procedural në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë pretendimet e tij.
9. Deri më sot, parashtruesi nuk u është përgjigjur kërkesave të Gjykatës.
10. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KI142/14, e caktoi veten anëtare të Kolegjit shqyrtues në zëvendësim të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit mandati si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese i mbaroi më 26 qershor 2015.
11. Më 7 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes, e cila ishte e lidhur ndërmjet Komunës së Podujevës dhe palës së tretë në lidhje me një paluajtshmëri.
13. Më 24 shkurt 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 471/2010) refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.
14. Më 7 korrik 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi C. nr. 471/2010) e refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën e tij në pronë, të garantuar me Kushtetutë dhe me DUDNJ.
16. Në lidhje me këtë kërkesë, parashtruesi pretendon se *“[...] gjate tri dekadave të kaluara, nga ana e drejtësisë më është mohuar e drejta e sigurisë në çështjen banesore të përfituar para 50 viteve”*.
17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata: *“[...] Të ma kthejnë banesën time ku kam jetuar për një kohë të gjatë së bashku me familjen time”*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Prandaj, Gjykata i referohet dispozitës së Ligjit, e cila përcakton:

Neni 22.4 [Procedimi i kërkesës]

“[...] 4. Nëse kërkesa [...] nuk është [...] e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të plotësuar kërkesën [...]”

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullave 29 (1) dhe 32 (5) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

Rregulli 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve]

“(1) [...] Kërkesa [...] duhet të përfshijë datën e parashtrimit të saj dhe të jetë e nënshkruar nga personi që e parashtron atë. [...]”

Rregulli 32 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

“(5) [...] Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është e jo e plotë [...]përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë [...] kërkesën [...]”.

21. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi e dorëzoi kërkesën të panënskruar nëpërmjet postës, më 19 shtator 2014.
22. Gjykata i ka dërguar dy letra parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar nga ai që t'i përmbushë kërkesat procedurale të parapara me rregullin 29 (1) të Rregullores së punës, respektivisht të nënshkruajë kërkesën e dorëzuar në emrin e tij.
23. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk i është përgjigjur asnjërës nga letrat e dërguara nga Gjykata dhe kështu nuk arriti të përmbushë këtë kërkesë procedurale.
24. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk mund të marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, pa e përmbushur kërkesën e lartpërmendur procedurale.
25. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk është e kompletuar dhe duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër, si dhe të hiqet nga lista sipas rregullit 32 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, më 6 gusht 2015 njëzëri

VENDOS

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

